



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 05

Datë: 13. 01. 2021. Ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

-Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi i dhe miratimi i Qendrave të Votimit, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

-Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit për mënyrën e përzgjedhjes të Personelit Teknik të QV-ve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional të Sigurisë së KQZ-së, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

5. Të ndryshme.

1. Hyrie: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përshëndetje, e morëm edhe pikën e dytë. Fillojmë me mbledhjen e pestë të KQZ-s. A ka vërejtje në rend ditës? Nëse jo. Kush është për miratimin e këtij rendi të ditës? Miratohet rendi i ditës... Faleminderit, fillojmë me aktivitetet e SKQZ-s, urdhëro Burim.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare të nderuar anëtar të KQZ-s. Sekretariati është në përgatitje e procesit komfort planit operacional dhe sot ka filluar periudha e aplikimit për votues jashtë Kosovës, periudhë e cila do të përfundoj me 21 janar 2021 në ora 18:00 sipas kohës lokale të Kosovës. Sekretariati i KQZ-s i ka publikuar të gjitha informatat e nevojshme dhe detajet duke përfshirë formularët për aplikim, për regjistrim, tekstet shpjeguese dhe pyetjet që më së shpeshti i bëjnë qytetarët. Pra të gjitha këto informacione i ka publikuar sekretariati ndërsa për votuesit që sukseshëm kanë aplikuar për regjistrim për zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 dhe në zgjedhjet komunale të komunës së Podujevës dhe të Mitrovicës së Veriut. Shërbimi votues ka dërguar e-mailat për konfirmim me formularët e aplikimit për regjistrim si dhe pyetjet e parashtruara. Pra këto janë informacionet që i kemi dërguar tek të gjithë këta aplikues të cilët kanë qenë të regjistruar sukseshëm në këto dy palë zgjedhje. Është një ndryshim sa i përket lokacionit ku do të zhvillohet puna për operimin votues për shkak të funksionalitetit nuk kemi mundur në objektin e ndërtesës së Rilindjes ta funksionalizojmë për shërbimin votues objektin dhe objekti i cili do të jetë funksional dhe ku do të zhvillohet gjitha aktivitetet dhe procedurat sa i përket shërbimit votues jashtë Kosovës janë në objektin e Ministrisë së Infrastrukturës objekt të cilin jemi në akomodim e sipër dhe kosiderojmë që sot pasdite pasi ta kompletojmë të gjithë këtë objekt do të mund të zhvillohet dhe të filloj në ndërrimin e pasditës puna.

Pra. Tha z. Ahmetaj, jemi akoma në procesin e akomodimit pavarësisht kësaj deri më tani kemi diku 1.500 aplikime të cilat kanë ardhur përmes e-mailit, i kemi tri e-maile aktive mirëpo kjo nuk e përjashton mundësin që të kemi dublikim në të gjitha e-mailet . përndryshe pjesa tjetër e stafit janë akomoduar nëpër hapësira tjera ndërsa në objektin e Ministrisë së Infrastrukturës do të jetë shërbimi për votim jashtë Kosovës, jemi në përgatitje dhe nga nesër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të mund të e vizitojë dhe ti shoh ambientin se ku do të punojnë për votimin jashtë vendit. Faleminderit, nëse keni pyetje mund të përgjigjem.

Valdete Daka: Faleminderit Burimit për sqarimin, por kur vjen puna të aplikimi më email të personave që kanë qenë të regjistruar të suksesshëm në vitin 2019 dhe zgjedhjet e vitit të kaluar për komunën e Podujevës dhe Mitrovicës se Veriut. Kemi një shqetësim nga disa qytetar që nuk pranojnë gjithmonë përgjigje do më than është një gabim teknik dhe ju kisha lutur që të e adresoni sa më shpejt, dhe së dyti ka pasur shqetësime se adresat aplikantet ja kanë pa njeri tjetrit sepse kanë qenë.. ju kisha lutur sekretariatit që të i korrigjon sepse në bazë të udhëzimit administrativ dhe që është aprovuar dje një person mundet të aplikoj për rrethin e ngushtë familjar. Pra nuk kemi nevojë që ta përsërisim të njëjtën fjalë.

Burim Ahmetaj: Po ashtu ju informoj që në objektin e ndërtesës së rilindjes ku janë edhe ministrat tjera pra në atë objekt KQZ-ja e shfrytëzon pra aty do të ngritët edhe qendra e thirrjeve ku do të punojmë me dy ndërrime nga ora 08:00 deri 16:00 dhe nga ora 16:00 deri në orën 00:00, kështu që konsideroj që do të mundemi të i përshtatemi ehe zonave kohore për thirrje për votuesit jashtë vendit. Faleminderit.

3.Aktivitetet e ZRPPC-së

Yll Buleshkaj: Faleminderit shumë Kryetare. Nga dje nuk është që kemi tepër zhvillime, i kemi dy zhvillime që ja vlen të përmenden për ju sot, i kemi pranuar të gjitha raportet financiare të fushatës nga partitë politike të cilat kanë marrur pjesë për zgjedhje të kryetarit të komunës në Mitrovicë të Veriut dhe në Podujevë pra nuk kemi nevojë të shqyrtojmë ndonjë masë ndaj këtyre subjekteve politike, e dyta është që kemi filluar të pranojmë aplikacione akreditim të vëzhguesve dje kemi pranuar aplikacionin e par nga një media që ka qendër në veriun e Mitrovicës, këto janë zhvillimet e ndryshme. Jemi duke kryer punët e zakonshme, duke pranuar aplikacione dhe duke shqyrtuar aplikacionet për certifikim. Aplikacione të reja

nuk kemi pranuar vetëm ato që i kemi përmendur dje, nga iniciativa qytetare Rome jemi në përpunim të dhënave kemi pasur disa sfida nga aspekti gjuhësor të cilat jemi duke i zgjidhur një nga një.

Valdete Daka: Mirë, nëse nuk kemi pyetje vazhdojmë.

Arianit Elshani: Jam konsultuar edhe me drejtorin e ZRPP-s, z. Buleshkaj edhe një gjë që nga administrata, sekretariati mundet ti ndihmoj këtu e krye shefi është mirë që formularët për vëzhguesit ndërkombëtar të përkthehen nga administrata në gjuhën angleze meqenëse ato të gjitha janë në gjuhën shqipe, formularët për vëzhguesit ndërkombëtar. Pra ta keni parasysh një koordinim edhe drejtori i zyrës ka shprehur vullnetin për një gjë të tillë që në të kaluarën nuk ka ndodhur kështu që faleminderit edhe drejtorin e zyrës për përkushtimin që ta ndihmoj këtë proces që të jenë edhe ato formular në gjuhën angleze për vëzhguesit ndërkombëtar. Faleminderit.

Valdete Daka: Mirë vazhdojmë me raportin e KQZ-s, urdhëro Alim.

4.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi i dhe miratimi i Qendrave të Votimit, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës:

Alim Rama: Faleminderit. Këshilli për operacione zgjedhore sot e ka shqyrtuar propozimin për miratimin e qendrave të votimit për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në sugjerimet e sekretariati desha të cek sekretariati ka rekomanduar dhe këshilli në mënyrë unanime ka aprovuar dhe rekomandon për aprovim në KQZ që disa qendra të vendvotimit që janë shumë afër njëra tjetrës ose që janë brenda objektit të bashkohen në një qendër si për shembull Shkolla Fillore Hasan Prishtina, Ulpianë ti bashkëngjitet një qendre të votimit e cila është Kopsht i fëmijëve me shumë pak votues. Po ashtu në fshatin Marec komuna e Prishtinës më saktësisht Shkolla Fillore Fan Noli ka një vendvotim me 287 votues. Pas vlerësimit nga zyrtarët komunal e cila propozon që qendra në fshatin Klllokoq, shkolla Iliria që ka në vendvotim me 70 votues të bartet në qendrën e votimit në fshatin Marec. I keni po ashtu në Slivov shkolla fillore Filp Shiroka që ka një vendvotim me 406 votues, pas vlerësimit nga zyrtari komunal i cili propozon që të bashkohet me qendrën në Slivov të Epërme edhe së bashku me tri qendra të votimit. Po ashtu në

Fakultetin Teknik brenda një objektit janë tri qendra që të bashkohen në një qendër ku një qendër në Fakultet Teknik në Prishtinë ka pesë njëra, tjetra pesë dhe njëra dy.

Pra, tha z. Rama, këto qendra të bashkohen dhe të bëhen një, po ashtu edhe në shtime në fshatin Pjetërshtic në shkollën Idriz Ajeti e cila ka vendvotimin me 1.019 votues pas vlerësimit të zyrtarit me votues në fshatin Karaqic edhe kjo shkolla nga fshati Karaqic të bartet në fshatin Pjetërqiç. Do të thotë këto janë rekomandimet, distancat në të gjitha këto vendvotime i plotësojnë brenda rregullativës ligjore që distanca është shumë afër ato fshatë janë zakonisht afër edhe ndonjë prej këtyre shkollave të vogla nuk përdoren. Po ashtu e kemi vërejtje në disa komuna që përdoren objekte private, në ato objekte që ka ndodhur problemi në Mitrovicën e Veriut në zgjedhjet e kaluara që kur të definohet një qendër të gjendet objekti i përshtatshëm në pajtueshmëri me KKZ-n. Por me prioritet të veçantë që të shfrytëzohet objekti i shtetit, aty është objekti i zyrës për pjesën veriore të Mitrovicës objekti është i madh dhe qoftëse ka nevojë le të vije direkt kërkesa prej KQZ-s për Ministrin e Punëve të Brendshme dhe administratën që ta rregulloj këtë punë, që të mos shfrytëzohen objekte private. Faleminderit.

Valdete Daka: Ne si përfundim i bie që do ti kemi 888 qendra të votimit në mbar Kosovën. Atëherë kush...

Eshref Vishaj: Kryetare, nëse kemi pasur më shumë qendra në vitin 2019 cila është arsyeja e reduktimit në 888.

Alim Rama: Kanë qenë shumë afër qendrat nga njëra tjetra. Në Fakultetin Teknik kanë qendër, tri qendra brenda një objektit. Sa për informatë, kanë qenë 895 më herët tash janë 888, shtatë më pak.

Valdete Daka: Atëherë, kush është për miratimin e qendrave të votimit?

Anëtarët e KQZ- së, miratuan Qendrat e Votimit. (V.D: Ndoshta, është mirë që sekretariati menjëherë ta publikoj dhe t'i njoftoj votuesit nëpërmjet zyrtarëve komunal.

Alim Rama: Sekretariati, është i udhëzuar që në këto lokacione ku janë këto qendra ti informojnë votuesit drejt për drejt nëpër fshatrat e veta.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër, udhëzimi për përzgjedhjen e personelit .

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit për mënyrën e përzgjedhjes të Personelit Teknik të QV-ve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Alim Rama: Po ashtu. sot në mbledhje këshilli e Këshillit për Operacione Zgjedhore në bazë të propozimit të sekretariatit, këshilli ka shqyrtuar dhe rekomandon në mënyrë unanime KQZ-n për aprovim formulën e ndarjes dhe punësimit e personave teknik nëpër qendrat e votimit dhe në bazë të formulës që keni para jush. Realisht këtu ka të bëjë vetëm shtohen për shkak të pandemisë nga një zyrtar në ato qendra ku janë mbi katër. Me formulën katër edhe tetë por formula këtu nuk ka ndërruar shumë sipas kërkesës por po besoj që sekretariati na jep shpjegim sepse formula ka qenë e qartë. Në këshill kemi votuar për ato qendra ku janë më shumë se katër, pesë e më shumë për një formulë katër, katër që ti shtohen shtesë asistentët që kontrollojnë reshtet nëpër oborret e atyre shkollave si masë parandaluese kundër COVID-it që mos të ketë grumbullim të madh të njerëzve.

Valdete Daka: Faleminderit Alim. Ndoshta ka mbetur këtu e keni tek faqja e tret tek kjo tabela ka mbetur që i keni 895 qendra të votimit, rregullojeni që të jetë “888” dhe sigurohuni që numri i vendvotimeve është i saktë. Sigurohuni para se ta nënshkruajmë vendimin, sigurohuni që këto shifra janë të sakta...

Eshref Vishaj: Unë mendoj që udhëzimi që është proceduar në komision për miratim nuk i përmbush standardet e një akti administrativ as në formë as në përmbajtje, as në mënyrën e procedimit, e shqyrtimit dhe miratimit të tij për miratim. Aktet nënligjore, shkojnë përmes këshillit për çështje ligjore jo përmes KOZ-it. E dyta udhëzimi administrativ nuk ka strukturë asnjë nen nuk ka, ka pika për të, nuk ka mbështetje në ligj. Nëse ka, më thoni sepse duke u bazuar në këtë nuk ka mbështetje në ligj sepse në rregullore ose në ligj e nxjerrim këtë udhëzim administrativ. Nuk e rregullon mënyrën e aplikimit apo procedurën e angazhimit të kombibusve, ZLKZ-t duhet të dalin tani në qytet dhe t’ju thonë ti, ti, ti mundesh ta kryesh punën për KKZ, dhe si i tillë për mendimin tim duhet të rishkruhet nga sekretariati i KQZ-s dhe departamenti për çështje ligjore dhe më pas të vije në komision për miratim.

Alim Rama: Ky nuk është udhëzim administrativ, është formular për zgjedhje, është udhëzues, pra nuk është udhëzues administrativ, kjo është vetëm formula e sekretariatit si ta bëjmë alokimin e personave dhe se, jo dhe mënyrën...!

Sami Hamiti: Këtë që e ngriti Eshrefi ka të drejt që duhet të bëhet, dhe atë në këshill të personelit duhet të shkoj. Po është e vërtet që edhe këto tema që i kemi trajtuar sot edhe në rolin e personelit edhe sidomos buxhetin kur e kemi aprovuar. Saktë, i kemi përkufizuar formatin edhe të asistentëve edhe në rregull Eshref është radha e dhjetë ndoshta që e ke aprovuar të njëjtin ti dhe unë më herët edhe është problemi që nuk kemi kohë sepse këta njerëz duhet të merren nesër, pasnesër deri sa të bëhen KVV-t. Prandaj para se të bëhet. Është aprovuar edhe në këshill të personelit, janë specifikuar si udhëzues si kanë me qenë këta sepse si numër kanë përfunduar.

Po them se ke të drejt që dokumenti si udhëzim fare nuk ka të drejt me udhëzim administrativ është një format si do të përzgjidhen sepse udhëzim nuk është ke të drejt je në një situatë ku janë specifikuar, janë kryer në këshill të personelit buxhetet janë aprovuar, janë reduktuar numrat sepse i kemi biseduar edhe në këshill të operacioneve. Kemi ardhur në një pozicion të tillë të cilët që tani është dashur të zgjidhet deri më tani.

Eshref Vishaj: I nderuar po pajtohem me ty se e kemi miratuar planin për angazhimin e stafit jo permanent, buxhetin por këtu kemi të bëjmë me një procedurë që duhet me respektua KKZ-ja edhe këtu ka defekte të shumta që një ndër to edhe e përmenda. Nëse eventualisht ka ndonjë procedurë që duhet ta përfillim KKZ-ve ja ku është kryeshefi në takim, kështu është praktika dhe ne kemi thënë që do ta rregullojmë këtë formë.

Alim Hamiti: Unë thash kjo është formulë për përzgjedhje që ka të bëjë me çështjet operative. Por sa i përket udhëzimit dhe rregullores sa e kuptova unë, Eshrefi ka qenë anëtar i KOZ-s më herët, këto nuk janë zgjedhjet e para unë nuk po e kuptoj pse nuk po ekziston një dokument siç e kërkohet por, formulën e përzgjedhjes e cakton KOZ-i.

Arianit Elshani: Ndoshta praktika në të kaluarën ka kërkuar që me kaluar përmes KOZ-it dhe unë pajtohem me z. Vishi që duhet të kaloj përmes këshillit për personel çështje të tilla. Realisht, unë jam anëtar i KOZ-it edhe e kemi trajtuar sa i përket formulës dhe afateve, kemi qenë dakord dhe e kam votuar pro, kam dhënë mbështetje për këtë udhëzim për mënyrën e përzgjedhjes. Mirëpo mendoj që çështje të tilla, dokumente të tilla duhet të trajtohen në komision për personel në momentin që rregullohen procedurat. Në këtë rast kemi afte edhe kemi formulën por nuk e kemi procedurën, procedura është çështje tjetër që mundet të trajtohet në këshill për çështje të personelit ato që i përmendi edhe z. Hamiti.

Nuk e kisha zgjatë më shumë këtë debat, tha z. Elshani porse, pajtohem me z. Vishin këto realisht duhet të diskutohen në këshill për personel. Si dokument e jap mbështetjen për aprovim në KQZ. Faleminderit.

Valdete Daka: Në rregull por ashtu siç e tha Samiu, disa here e kemi aprovuar të njëjtën çështje në forma të ndryshme kështu që edhe...

Čemailj Kurtiši: Nga aspekti formal juridik, është në rregull ajo që po e thotë edhe z. Vishi. Tash, kjo është dhe s'ka problem që të zbatohet, por në të ardhmen të përmirësohet...

Valdete Daka: Po të gjithë po pajtohem që z. Vishi ka të drejt sa i përket formës edhe ndoshta gjuhës së cilës është përpiluar kjo le të jetë vërejtje atyre që ju është kërkuar edhe mënyra si është përpiluar por gjithsesi ne sot duhet ta aprovojmë sepse afati na rrjedh dhe nuk kemi tjetër mundësi po herën tjetër ata të cilët i kërkojnë këto ti përgatisin në mënyrën e duhur. Po urdhëro Burim.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. Vetëm desha të lidhem tek numri i qendrave të votimit dhe numri i vendvotimeve, sigurisht se do të reflektoj tash numri i qendrave të votimit. Mirëpo numri i vendvotimeve lidhet edhe me krijimin e listës përfundimtare votuese kështu që është proces që jemi në proces e sipër dhe nuk mundemi ta kemi numrin e saktë por si referencë e kemi marr numrin e vendvotimeve dhe të vitit 2019. Mirëpo i qendrave do të reflektoj. Faleminderit.

Valdete Daka: Atëherë kush është për miratimin e këtij udhëzuesi? Jo s'i "udhëzim administrativ" por s'i "udhëzues...? Aprovohet, me një votë kundër.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional të Sigurisë së KQZ-së, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës:

Alim Rama: Po ashtu në këshill për operacione zgjedhore në bazë të rekomandimit të sekretariatit këshilli ka trajtuar. Plani operacional të sigurisë për zgjedhje Parlamentare të Republikës së Kosovës, plani është në formë standarde si të gjitha zgjedhjet e mëparshme. Plani në data të veçanta në takimet e koordinimit dhe masat që i ndërmerr KQZ-ja në bashkëpunim me instucionet relevante të Republikës së Kosovës kështu që nuk kam çka të shtoj në koordinim është i ngjashëm siç, ka qenë në Podujevë që e kemi aprovuar

kështu që tash është në nivel të Kosovës në mënyrë anonime KOZ-i rekomandon për aprovim. Vetëm kishim pasur një kërkesë nga sekretariati më herët që formularët të publikohen menjëherë që subjektet politike kur fillon fushat ti kenë formularët para vetës.

Valdete Daka: Unë gjithashtu kisha kërkuar nga sekretariati që të gjitha vendimet që merren në KQZ të publikohen menjëherë pas takimit. Kështu që të jenë të qasshëm për të gjithë ata që janë të interesuar dhe njëkohësisht kisha dashur të dijë se a janë të përfshirë në këtë plan dhe të gjithë pa masat anti COVID, sidomos gjatë fushatës e cila na pret. Pra jemi të vetëdijshëm se e kemi një para fushatë nga të gjitha subjektet politike dhe jo gjithmonë janë duke u respektuar por ato janë çështje të instucioneve të tjera.

Alim Rama: Ndoshta kishim pasur ndonjë rekomandim nga sekretariati ta merr një informatë shtesë prej IKSHP-s pasi kanë ndryshuar disa masa që të kemi komfirmim për këto zgjedhje për masat dhe tubimet.

Valdete Daka: Nuk besoj se ka ndonjë ndryshim, ne mundemi të kërkojmë dhe zyrtarisht sidomos sa i përket fushatës zgjedhore. Para fushata jo që nuk është e specifikuar por nuk është as e sanksionuar që i mbetet instucioneve kompetente që të kujdesen. Nëse nuk kemi diçka tjetër, unë ju falënderoj dhe shihemi nesër. Kush është për aprovimin e këtij plani...?

Miratohet...

Të ndryshme!